




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 220 / 18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina– Kryetar, Nuhi Paçarizi -Referues z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Alpha Private Security”- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: “K.S.AS-SECURITY” Sh.p.k lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi Fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit: 616-18-3310-2-1-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KK - Prishtinë me datën 20.06.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Alpha Private Security”- Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi Fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit: 616-18-3310-2-1-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KK - Prishtinë .

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i AK -së KK - Prishtinë lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull prokurimi “Sigurimi Fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit: 616-18-3310-2-1-5 .

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Alpha Private Security"- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Hapja e ofertave është bërë me dt: 15.05.2018

Data e njoftimit për dhënien e kontratës është bërë me dt: 21.05.2018

Data e njoftimit më letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm AK nuk e ka njoftuar OE- në ankues .

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik "Alpha Private Security"- Prishtinë me dt: 23.05.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me dt: 28.05.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE "Alpha Private Security"- Prishtinë si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues "Alpha Private Security"- Prishtinë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 28.05.2018 me nr. 220 / 18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi Fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës" me numër të prokurimit; 616-18-3310-2-1-5, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK/ KK - Prishtinë duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,10,59,60,61, dhe 26 pika 4.1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe RRUOPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 31.05.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 12.06.2018 sqaron se OE ankuese "Alpha Private Security" Sh.p.k-Prishtinë është kualifikuar si tenderues i pasuksesshëm nga AK-KK Prishtinë pasi që nuk ka qenë me çmim më të lirë ku kriter kryesor sipas AK-së ka qenë "çmimi më i ulët"

OE ankuese me datë 21.05.2018 ka bërë kërkesë për ri-shqyrtim dhe me datë 23.05.2018 AK refuzon kërkesën e OE-se ankuese me arsyetimin se kriter për dhënie të kontratës ka qenë çmimi më i ulët dhe se kriteret e dhënies së kontratës nuk ka qenë analiza e çmimeve siç pretendon OE-ankuese.

Eksperti shqyrtues mendon se AK-KK Prishtinë përkatësisht komisioni i vlerësimit nuk ju ka përmbajtur kërkesave (kritereve) të cilat vetë i ka përpiluar në dosjen e tenderit përkatësisht në Seksionin II. Fleta e të dhënave të tenderit (FDT) kapaciteti mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale nën 9.1 & 9.2 të FDT-së (kërkesa 2), si dhe në Aneksin I të dosjes, ku kërkohet nga ofertuesit që paga mujore bruto të jetë min 230.00€, andaj mendoj se gjatë vlerësimit të ofertave komisioni i vlerësimit është dashtë të ketë parasysh edhe çmimet e dhëna nga OE-të pjesëmarrës dhe ta bëjë një analizë sipas nenit 61 të LPP-së

AK-Komuna e Prishtinës këtë aktivitet të prokurimit e ka udhëhequr me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë duke u bazuar në nenin 35.2.1 (iii) mirëpo OE-ankuese nuk pajtohet me këtë pasi që sipas OE-së ankuese nuk shih ndonjë urgjencë siç e cek AK- KK-Prishtinë pasi që sipas OE-se ankuese shërbimet janë duke vazhduar pa asnjë vërejtje nga ana e AK-se dhe se kemi kontratë të nënshkruar nga data 01.06.2017 për një afat prej 36 muaj.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin që posedon mendon se AK me të drejtë ka përdorur procedurën e negociuar pa publikim duke pas parasysh se AK në njoftimin për komisionin rregullativ të prokurimit publik (në dok B50) të datës 10.05.2018 ka sqaruar po citoj: "AK-KK Prishtinë ka udhëhequr procedurë të prokurimit për Sigurimin fizik të objekteve të Komunës së Prishtinës, ku dorëzimi dhe hapja ka qenë me datë: 05.02.2018 dhe pas vlerësimit të ofertave AK ka përzgjedhur njërin prej OE-ve i cili ka çmimin e përgjegjshëm me të ulët dhe i plotëson të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, mirëpo njeri prej OE-ve ka dorëzuar ankesë pranë OSHP-së dhe se kjo procedurë është ende e pa zgjidhur. Komuna e Prishtinës ka kontratë për sigurimin fizik me OE-në "Alpha Private Security" e cila kontratë është në përmbushje, andaj AK është detyruar të udhëheq procedurë të negociuar pa publikim për sigurimin fizik deri në përzgjedhjen e Operatorit të ri Ekonomik- deri në përfundimin e shqyrtimit të ankesës nga ana e OSHP-se"

Pretendimi i OE-së ankuese se nuk shohin ndonjë urgjencë pasi që shërbimet janë duke vazhduar pa asnjë vërejtje nga ana e AK-se, eksperti shqyrtues mendon se duke u bazuar në e-mailat e AK-së (në mes udhëheqësit të prokurimit dhe menaxherit të kontratës) ky pretendim i OE-së ankuese nuk qëndron pasi që kontrata që është lidhur në mes AK-KK Prishtinë dhe OE-së "Alpha Private Security" është në përmbushje duke përfshi edhe vlerën totale indikative + (plus) 30 % sipas nenit 38 paragrafi 2 i LPP-së

Duke pas parasysh se ky Nen përkatësisht paragrafi 1 i këtij neni thekson se: “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Eksperti shqyrtues mendon se ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm, AK respektivisht komisioni i vlerësimit nuk ka vepruar në mënyrë transparente lidhur me OE-të pasi që AK nuk i ka njoftuar OE-të me Letra standarde për tenderuesin e Suksesshëm apo për tenderuesin e Pasuksesshëm. OE-ankuese rezultatin e këtij aktiviteti e kupton pasi që AK-KK-Prishtinë ka bërë njoftimin për dhënie të kontratës ku është bërë publike në sistemin e E-Prokurimit me datë: 21.05.2018.

Duke u bazuar në këtë nen përkatësisht në paragrafin 3 ku ndër të tjera thuhet se: “Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni,

Eksperti shqyrtues mendon se ky pretendim ankimor është i paqëndrueshëm, pasi që AK-KK Prishtinë me momentin e kërkesës për rishqyrtim nga OE ankuese, AK i ka dhënë qasje në dokumentacion ku edhe është bërë një Procesverbal i qasjes në dokumentacion me datë: 21.05.2018 ku janë nënshkruar përfaqësuesi i OE-së ankuese dhe personi i autorizuar i AK-së dhe nuk ka pas vërejtje nga asnjëra palë.

Duke u bazuar në këtë nen përkatësisht në paragrafin 4 dhe 4.1 ku thuhet se po citoj: “Personat e autorizuar që të nënshkruaj në sipas paragrafit 1. Dhe 2. ose 3. të këtij neni mund të nënshkruaj në kontratë në tillë vetëm nëse për mbushen kushtet vijuese:

Së paku dhjetë (10) ditë kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës; me kusht që, ky kusht të mos aplikohet për prokurimet urgjente që sipas nenit 35.2.1 (iii). Apo për një aktivitet të prokurimit të bazuar në nenin 36. Apo për kontrata me vlerë minimale”

Eksperti shqyrtues mendon ky pretendim i OE-së ankuese është i paqëndrueshëm, pasi që AK duke e parë urgjencën për këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në nenin 26 paragrafi 4.1 ka vepruar në harmoni me LPP-në, pasi që në Njoftimin për KRPP-në (dok B50) AK jep sqarime se ky aktivitet është i natyrës urgjente duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika (iii) të LPP-së

Sa i përket Nenit 59 i LPP-së së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve)

Eksperti shqyrtues mendon se ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm

Pasi që në paragrafin 2 i Nenit 59 të LPP-së, ia ka mundur AK-së që të kërkojnë sqarime mbi cilindo aspekt të tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahësimi i tenderëve mirëpo asnjë ndryshim të materialit ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkojë ose pranohet nga autoriteti kontraktues, në këtë rast AK respektivisht komisioni i vlerësimit pasi që e ka pas si kërkesë (kriter) në dosjen e tenderit edhe pagën minimale prej 230 € bruto, është dashtë që të kërkojë sqarim rreth çmimeve me të cilat kanë ofertuar OE-të pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Sa i përket Nenit 60 i LPP-së (Kriteret për dhënien e kontratës)

Duke pas parasysh se ky Nen përkatësisht paragrafi 1.1 i këtij Neni, ku AK do te shpërblej tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Eksperti shqyrtues mendon se OE- i shpërblyer me kontratë ka çmimin me të ulët nga të gjithë OE-të pjesëmarrës, mirëpo çmimi për orë pune i dhënë nga OE- i shpërblyer me kontratë është më i ultë se sa shpenzimet që i shkaktohen OE-së. shih përgjigjen ne pretendimin nr.8

Sa i përket Nenit 61 i LPP-së (Tenderët Jo-normalisht të ulët)

Në Dosjen e tenderit përkatësisht në Seksionin II. Fleta e të dhënave të tenderit (FDT) kapaciteti mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1& 9.2 të FDT-së (kërkesa 2), si dhe ne Aneksin1 të dosjes, AK kërkon se paga mujore bruto për një punëtor nga ofertuesi i shërbimeve kërkohet të jetë së paku 230 €, për një muaj, mirëpo nuk ceket se sa orë pune duhet të kryej një punëtor i sigurimit gjatë një muaji në shpërblim të pagës 230 €.

Eksperti shqyrtues konstaton se OE-i shpërblyer me kontratë ka dhënë deklaratën me shkrim sipas kërkesës se AK-së, se punëtorëve që do të paguaj pagesën minimale bruto 230 € për një muaj.

Eksperti shqyrtues përmes sistemit online të ATK-së ne linkun: <http://ëëë.atk-ks.org/33184-2/> ka bërë llogaritjen e pagës nga Bruto ne Neto, ku janë paraqitur të gjitha taksat dhe kontributet

shih tabelën e më poshtme: shih përgjigjen ne pretendimin nr.8

Sqarim: Nëse e marrim për bazë se për një orar të rregullt një i punësuar punon 40 orë në javë apo 176 orë në muaj, ofertën e OE-së së shpërblyer me kontratë e llogaritim si më poshtë:

Oferta e OE-së e cila është shpërblyer me kontratë nga AK-KK Prishtinë, çmimin për orë pune e ka 1.52 € ky çmim përfshinë edhe TVSH-në

Nëse çmimin për orë pune me TVSH e lirojmë nga TVSH-ja (pasi që TVSH-ja është obligim për OE-në) i bije: $1.52 \text{ €} / 1.18 \text{ €} = 1.2881 \text{ €}$ (për një orë punese do ti ketë 1.2881 €)andaj duke bërë një llogaritje ku OE ka deklaruar se paga minimale për një muaj do të jetë 230 € + 5% kontributi i punëdhënësit 11.50 € = 241.50 €

Totali i përgjithshëm $230.00 + 11.50 = 241.50 \text{ €}$ (pra 241.50 € do ti kushtojë OE-së për ta paguar një punëtor për një muaj). ose,

Nëse e pjesëtojmë 241.50 € me 176 orë pune i bije $241.50 / 176 = 1.37 \text{ €}$ (pra 1.37 € do ti kushtoj OE-së për ta paguar një punëtor për një orë pune).

OE i shpërblyer me kontratë gjatë realizimit te kësaj kontrate nëse do të respektoj pagesën ne punëtorit, do të punoj me humbje, më poshtë keni ne formë tabelore kroniken e lartcekur.

Mirëpo edhe OE-ankuese me çmimin e dhënë prej 1.63 € për një orë pune duke përfshi në këtë çmim edhe TVSH-në dhe duke u bazuar ne deklaratën e tij se pagat e punëtorëve do te jenë 230€ bruto dhe se do te respekton te gjitha ligjet që janë në fuqi. Eksperti shqyrtues mendon se edhe OE-ankuese po të ishte

shpërblyer me kontratë do të punonte pa fitim nëse do t'ju kishte përmbajtur deklaratës së tij. Më poshtë keni në formë tabelore edhe ofertën OE-së ankuese.

Eksperti shqyrtues mendon se duke pas parasysh se AK KK- Prishtinë tani më ka lidhë kontratë me OE-në K.S AS-Security sh.p.k dhe duke marrë për bazë se OE me vetëdije ka nënshkruar kontratën dhe ka deklaruar se e përmbush kriterin për pagën 230 € bruto për një muaj dhe duke u bazuar se prishja e kontratës në mënyrë të një anshme shkakton dëme më të mëdha materiale dhe financiare, duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankuese: "Alpha Private Security" S.p.k - Prishtinë të aprovohet pjesërisht si e bazuar, dhe të mbetet në fuqi njoftimi për dhënie të kontratës dhe njoftimi për nënshkrimin e kontratës për aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 14.06.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.06.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoriteti kontraktues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Ramaj deklaroj: Ne kemi qenë të ftuar në këtë aktiviteti që ka qenë si formë e negociuar. Kemi qenë pjesëmarrëse tri kompani operuese. Ndër to kemi dal e dyta me çmim më të lirë të përgjegjshëm.

AK ka shpall fitues OE "AS Security" e cila sipas kërkesave të AK lidhur me pagën nuk plotëson kërkesat as për së afërmi kërkesat për pagën e punëtorëve.

Si dëshmi këtë e ka cek edhe eksperti se OE në fjalë për këtë kontratë për tre muaj del të punoj me humbje - 5,989€.

Ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK e cila na është refuzuar dhe për çudi duke mos u bazuar në rregullore për parashtrim të ankesave dhe LPP, dhe ligjeve të parapara në vendim tonë, kemi parë njoftimin se AK ka nënshkruar kontratë pa respektuar afatet ligjore.

Ne jemi drejtuar me ankesë në OSHP dhe qëndrojmë pranë ankesës tonë, kërkojmë që ankesa jonë të aprovohet në tërësi dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Lidhur me mendimin e ekspertit se duhet të mbetet në fuqi vendimi i AK, edhe pse kanë ndodh shkelje ligjore ne nuk pajtohemi, pasi që edhe për kundër përfundimit të kontratës tonë me AK-në ne asnjë here nuk

kemi marr ndonjë njoftim zyrtar nga AK që të ndërpriten shërbimet edhe për kundër faktit se disa here kemi kërkuar nga AK të na bëhet një njoftim zyrtar.

Ne kuptojmë urgjencën e AK-së, mirëpo përderisa lejohen të bëhen shkelje tilla dhe na cenohet e drejta e ankesës, na shkaktohen dëme të pariparueshme materiale, dhe është absurd e kur vet AK në aktivitetin e prokurimit të shpallur të rregullt për periudhë një vjeçare me 07.06.2018 dërgon një vendim lidhur me kërkesën për rishqyrtim të një OE tjetër Rojet e Nderit, dhe kompaninë e shpallur fituese e cek si manipuluese me numrin e punëtorëve.

Kompani e njëjtë që është shpall fitues edhe në procedurë të negociuar, atëherë si është e mundur që me njëjtin çmim në dyja aktivitetet, në njërën të cilësohet manipuluese dhe tjetrën të ketë mundësi nënshkrimi kontrate kur kompania është duke punuar me humbje.

Si provë ju ofrojmë vendimin në kërkesë për rishqyrtim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi e AK-së z. Mekolli deklaroj: Un nuk di për sa aktivitete OE ankues ka ar në përfaqësoj në seancë, dhe nuk kuptoj si i është cenuar e drejta e ankesës, përderisa janë shqyrtuar kërkesa për rishqyrtim dhe është parashtruar ankesa në OSHP.

AK – KK Prishtinë, ka udhëhequr një procedurë të rregullt të prokurimit lidhur me tenderin sigurimi fizik i objekteve të komunës, procedurë që ka shkuar në ankesë dhe e cila është parë se do të zgjatet.

Për të mos mbetur pa kontratë dhe për ti shmang problemet për mungesë të një kontrate mbështetur në LPP neni 35.2, Ak- KK Prishtinë, ka udhëhequr një procedurë të negociuar pa publikim. AK KK Prishtinë ka ftuar katër OE lidhur me procedurë ku tre prej tyre kanë dorëzuar ofertat e tyre. Në njoftim për kontratë dhe dosje kriteret kanë qenë shumë të qarta ku kriter ka qenë çmimi më i lirë, andaj edhe OE “K.S.AS-SECURITY” ka plotësuar gjitha kërkesat e kërkuara në njoftim për kontratë dhe dosje dhe ka dhënë çmimin më të lirë.

AK në fund e mbështet raportin e ekspertit shqyrtues i cili i propozon panelit të mbetet në fuqi njoftimi për dhënie të kontratës dhe njoftimi për nënshkrim të kontratës.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Ramaj deklaroj: Do pyesja përfaqësuesin e AK se a është ligjore të bëhet nënshkrimi i kontratës derisa ka procedurë të ankesës pikërisht për këtë lëndë.

I propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK z.Mekolli deklaroj: Qëndrojmë pranë vendimit të AK dhe i propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në

procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankuese “Alpha Private Security” Sh.p.k- Prishtinë është kualifikuar si tenderues i pasuksesshëm nga AK-KK Prishtinë pasi që nuk ka qenë me çmim më të lirë, sepse kriter kryesor sipas AK-së ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, sqaron se AK-ja këtë aktivitet të prokurimit e ka udhëhequr me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontrate duke u bazuar në nenin 35.2.1 (iii), mirëpo OE-ankues nuk pajtohet me këtë, pasi që sipas OE-së ankues nuk sheh ndonjë urgjencë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, sepse shërbimet janë duke vazhduar pa asnjë vërejtje nga ana e AK-së dhe se ky OE ka kontratë të nënshkruar nga data 01.06.2017 për një afat prej 36 muaj.

Paneli shqyrtues sqaron se kontrata që është lidhur në mes AK-KK Prishtinë dhe OE-së “Alpha Private Security” është në përmbushje duke përfshi edhe vlerën totale indikative + (plus) 30 % sipas nenit 38 paragrafi 2 i LPP-së.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin që ka pasur në posedim, sqaron se AK e ka njoftuar Komisionin Rregullativ për Prokurimit Publik (dok B50) me datë 10.05.2018 konform nenit 35 të LPP-së, duke e dhënë arsyetimin si në vijim: *“AK-KK Prishtinë ka udhëhequr procedurë të prokurimit për Sigurimin fizik të objekteve të Komunës së Prishtinës, ku dorëzimi dhe hapja ka qenë me datë: 05.02.2018 dhe pas vlerësimit të ofertave AK ka përzgjedhur njërin prej OE-ve i cili ka çmimin e përgjegjshëm me të ulët dhe i plotëson të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontrate dhe në dosje të tenderit, mirëpo njeri prej OE-ve ka dorëzuar ankesë pranë OSHP-së dhe se kjo procedurë është ende e pa zgjidhur. Komuna e Prishtinës ka kontrate për sigurimin fizik me OE-në “Alpha Private Security” e cila kontrate është në përmbushje, andaj AK është detyruar të udhëheq procedurë të negociuar pa publikim për sigurimin fizik deri në përzgjedhjen e Operatorit të ri Ekonomik- deri në përfundimin e shqyrtimit të ankesës nga ana e OSHP-së”*. Duke u bazuar në dëshmitë që ka pasur në dispozicion, paneli shqyrtues nuk ka vërejt ndonjë parashtrësë kundërshtuese apo ndonjë vërejtje nga ana e Komisionit rregullativ për Prokurim Publik (KRPP).

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se nuk janë njoftuar me letra standarde, paneli shqyrtues mendon se ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm, sepse AK nuk i ka njoftuar OE-të me letra standarde për tenderuesin e eliminuar apo për tenderuesin e pasuksesshëm, mirëpo ky fakt nuk ka ndikuar në rezultatin final, ndërsa obligohet autoriteti kontraktues që në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues për shkelje të nenit 10 të LPP-së, paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha dëshmitë që ka pasur në dispozicion, sqaron se është i paqëndrueshëm ky pretendim, sepse ekziston një procesverbal i qasjes në dokumentacion me datë:21.05.2018 ku janë nënshkruar përfaqësuesi i OE-së ankues dhe personi i autorizuar i AK-së, e ku vërehet se nuk ka pas vërejtje nga asnjëra palë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se autoriteti kontraktues ka nënshkruar kontratën pa e pritur afatin për ankesa, paneli shqyrtues sqaron se AK-ja me ratsin e nënshkrimit të kontratës ka pasur parasysh paragrafin 4 dhe 4.1 të nenit 26 të LPP-së, ku thuhet se, citoj:“Personat e autorizuar që të nënshkruajnë sipas paragrafit 1 dhe 2 ose 3 të këtij neni mund të nënshkruajnë kontratë të tillë vetëm në se për mbushen kushtet vijuese: Së paku dhjetë (10)ditë kanë kaluar nga data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës; me kusht që, ky kusht të mos aplikohet për prokurimet urgjente që sipas nenit 35.2.1 (iii). Apo për një aktivitet të prokurimit të bazuar në nenin 36. Apo për kontrata me vlerë minimale.” Pra autoriteti kontraktues e ka pasur parasysh urgjencën e këtij aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se nuk është respektuar neni 61 i LPP-së, paneli shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit përkatësisht në Seksionin II. Fleta e të dhënave të tenderit (FDT) kapaciteti mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1& 9.2 të FDT-së (kërkesa 2), si dhe ne Aneksin 1 të dosjes, AK ka kërkuar se paga mujore bruto për një punëtor nga ofertuesi i shërbimeve kërkohet të jetë së paku 230 €, për një muaj, mirëpo nuk ceket se sa orë pune duhet të kryej një punëtor i sigurimit gjatë një muaji në shpërblim të pagës 230 €.

Paneli shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë deklaratën me shkrim sipas kërkesës se AK-së, se punëtorëve do tu paguaj pagesën minimale bruto 230 € për një muaj.

Paneli shqyrtues sqaron se ekspertit profesional përmes sistemit online të ATK-së ne linkun: <http://www.atk-ks.org/33184-2/> ka bërë llogaritjen e pagës nga Bruto ne Neto, ku janë paraqitur të gjitha taksat dhe kontributet si në vijim:

Sqarim: Nëse e marrim për bazë se për një orar të rregullt një i punësuar punon 40 orë në javë apo 176 orë në muaj, ofertën e OE-së së shpërblyer me kontratë e llogaritim si më poshtë:

Oferta e OE-së e cila është shpërblyer me kontratë nga AK-KK Prishtinë, çmimin për orë pune e ka 1.52 € ky çmim përfshinë edhe TVSH-në

Nëse çmimin për orë pune me TVSH e lirojmë nga TVSH-ja (pasi që TVSH-ja është obligim për OE-në) i bije: $1.52 \text{ €} / 1.18 \text{ €} = 1.2881 \text{ €}$ (për një orë punese do ti ketë 1.2881 €)andaj duke bërë një llogaritje ku OE ka deklaruar se paga minimale për një muaj do të jetë $230 \text{ €} + 5\% \text{ kontributi i punëdhënësit } 11.50 \text{ €} = 241.50 \text{ €}$

Totali i përgjithshëm $230.00 + 11.50 = 241.50$ € (pra 241.50 € do ti kushtojë OE-së për ta paguar një punëtor për një muaj). ose,

Nëse e pjesëtojmë 241.50 € me 176 orë pune i bije $241.50 / 176 = 1.37$ € (pra 1.37 € do ti kushtoj OE-së për ta paguar një punëtor për një orë pune).

OE i shpërblyer me kontratë gjatë realizimit të kësaj kontrate nëse do të respektoj pagesën në punëtorit, do të punoj me humbje, më poshtë keni në formë tabelore kroniken e lartcekur.

Mirëpo edhe OE-ankues me çmimin e dhënë prej 1.63 € për një orë pune duke përfshi në këtë çmim edhe TVSH-në dhe duke u bazuar në deklaratën e tij se pagat e punëtorëve do të jenë 230€ bruto dhe se do të respekton të gjitha ligjet që janë në fuqi. Sipas ekspertit profesional edhe OE-ankues po të ishte shpërblyer me kontratë do të punonte pa fitim nëse do t'iu kishte përmbajtur deklaratës së tij

Paneli shqyrtues duke pasur parasysh sqarimin e lartcekur të ekspertit profesional, si dhe duke pasur parasysh se AK KK- Prishtinë tani më ka lidhë kontratë me OE "K.S AS-Security sh.p.k", e i cili OE me vetëdije ka nënshkruar kontratën dhe ka deklaruar se e përmbush kriterin për pagën 230 € bruto për një muaj, kurse duke pasur parasysh se prishja eventuale e kontratës do të sillte pasoja më të mëdha se sa lënia në fuqi e kësaj kontratë, atëherë vjen në përfundim se ankesa duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa të vërtetohet njoftimi për dhënie të kontratës. Paneli shqyrtues në këtë rast pati parasysh dëmet e mundshme në interesin publik që mund të rezultojnë nga ky veprim, sidomos ka pasur parasysh sqarimin e ekspertit profesional se edhe OE ankues po të ishte shpërblyer me kontratë do të punonte pa fitim nëse do t'iu kishte përmbajtur deklaratës së tij.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar konform këtij neni. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka marrë parasysh dhe ka vepruar duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - KK - Prishtinë

1x1 "Alpha Private Security"- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.